



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 02.11.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 107 të Ligjit të Procedurës Administrative nr. 02/L-28, pas njoftimit me të dhënat se znj. Sevdije Zhubi nuk mund të angazhohet në punën e Komisionit të formuar sipas vendimit 01. Nr. 112-76633 i dt. 26.10.2015, për shkak se ky veprim bie ndesh me nenin 16.3 nënparagrafi 3.1 dhe 3.2 të Rregullores së MF- 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, me dt: 02.11.2015, e miraton këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet pika e parë e vendimit 01. Nr. 112-76633, dt. 26.10.2015 për formohet Komisioni për pranim dorëzimin e dosjeve dhe të inventarit të Avokaturës Publike të Komunës së Gjakovës, duke e zëvendësuar anëtarin e Komisionit të evidentuar në numrin rendor dy (2) znj. Sevdije Zhubi me anëtarin e re të këtij komisioni znj. Afërdita Vula, ashtu që përbërja e re e këtij Komisioni është si vijon:

:

1. Venera Shtaloja, kryetare
2. Afërdita Vula, anëtare
3. Flamur Vula, anëtar

2. Pjesa tjetër e vendimit 01. Nr. 112-76633 i dt. 26.10.2015, mbetet plotësisht në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Znj. Vjollca Shyti
- Znj. Erlinda Rizvanolli
- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**

